

LIGJ
Nr.8372, datë 9.7.1998

**PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE KONSULLORE NGA PËRFAQËSITË
DIPLOMATIKE OSE KONSULLORE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", bazuar në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, datë 10.4.1961; në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet konsullore, datë 24.4.1963; në normat e tjera përkatëse ndërkombëtare dhe të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. VEPRIMTARIA KONSULLORE E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE OSE KONSULLORE

Neni 1

**Detyrat e përgjithshme të përfaqësisë diplomatike
ose konsullore në veprimtarinë e tyre konsullore**

1. Përfaqësitë diplomatike a konsullore në veprimtarinë e tyre konsullore mbështetin bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit pritës, duke synuar zgjerimin e lidhjeve në fushën e ekonomisë, përparimit, transportit, kulturës, shkencës dhe të së drejtës.

2. Përfaqësitë diplomatike a konsullore në veprimtarinë e tyre konsullore mbrojnë interesat dhe të drejtat e shtetasve shqiptarë në vendin pritës, të cilat burojnë nga normat e ligjet ndërkombëtare e të shtetit pritës dhe i ofrojnë atyre ndihmë këshillimore e juridike, kur kërkohet dhe për sa është e mundur.

3. Përfaqësitë diplomatike a konsullore, në veprimtarinë e tyre konsullore, për sa lejojnë kompetencat, kontrollojnë zbatimin e konventave, të traktateve e marrëveshjeve dy a shumëpalëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë dhe shteti pritës.

4. Përfaqësitë diplomatike a konsullore, në veprimtarinë e tyre konsullore mbështesin forcimin e lidhjeve dhe të bashkëpunimit ndërmjet diasporës shqiptare dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufime

Me "post konsullor" nënkuptohet përfaqësia ose zyra konsullore, pra sipas rastit konsullata e përgjithshme, konsullata, nënkonsullata, agjencia konsullore a sektori konsullor (konsullorja) në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Me "drejtues të postit konsullor" nënkuptohet titullari i përfaqësisë a zyrës konsullore, pra sipas rastit konsulli i përgjithshëm, konsulli, nënkonsulli, drejtuesi i agjencisë konsullore ose i sektorit konsullor në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Me "nëpunës konsullor" nënkuptohet nëpunësi i emëruar në një post konsullor, i ngarkuar me funksione konsullore.

Me "vend/shtet pritës" nënkuptohet vendi/shteti ku është akredituar drejtuesi i postit konsullor.

Me "rreth juridiksioni" nënkuptohet territori në vendin/shtetin pritës ku drejtuesi i postit konsullor është i autorizuar të kryejë veprimtarinë konsullore.

II. NORMA TË PËRGJITHSHME, KOMPETENCAT DHE DETYRAT KONSULLORE

Neni 3

Ushtrimi i kompetencave konsullore

1. Funksionet konsullore në postin konsullor i ushtron drejtuesi i postit konsullor, i cili mund të jetë konsulli i përgjithshëm (drejtuesi i konsullatës së përgjithshme), konsulli (drejtuesi i konsullatës), nënkonsulli (drejtuesi i nënkonsullatës), drejtuesi i agjencisë konsullore ose drejtuesi i sektorit konsullor (konsullorës) të përfaqësisë diplomatike. Drejtuesi i postit konsullor i ushtron funksionet konsullore në rrethin e juridiksionit, i cili mund të përfshijë të gjithë territorin e shtetit pritës ose një pjesë të tij.

2. Funksionet konsullore, që ushtron drejtuesi i postit konsullor, rrjedhin nga kompetencat konsullore, me të cilat është pajisur posti konsullor me këtë ligj.

3. Drejtuesi i postit konsullor mund t'ia delegojë kompetencat e tij nëpunësve konsullorë me kualifikimin e nevojshëm në postin konsullor, duke marrë për këtë miratimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në përfaqësitë diplomatike, në të cilat nuk funksionon ende sektori konsullor (konsullorja), me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme, funksionet konsullore mund t'i ushtrojë një anëtar i shërbimit diplomatik.

4. Me urdher të veçantë të Ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuesi i postit konsullor mund të ushtrojë funksionet konsullore që i janë ngarkuar edhe jashtë rrethit të juridiksionit.

Për këtë ai duhet të marrë më parë pëlqimin e shtetit pritës.

5. Drejtuesi i postit konsullor, në ushtrimin e funksioneve konsullore që i janë ngarkuar, varet nga Ministri i Punëve të Jashtme, nga i cili merr dhe udhëzimet e drejtpërdrejta. Mbi veprimtarinë e tij ushtron kontroll të drejtpërdrejtë titullari i përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin pritës.

6. Organizimi i posteve konsullore, si dhe të drejtat e detyrat e nëpunësve konsullorë përcaktohen nga normat dhe rregulloret përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

7. Në të gjitha rastet, kur në këtë ligj përmendet termi "shtetas shqiptar", rregulli përkatës ka vlerë dhe për personat juridikë shqiptarë, autoritetet a institucionet e tjera shqiptare, veç rasteve kur kjo përfshihet shprehimisht.

Neni 4

Dhënia e ndihmës shtetasve shqiptarë, kur ata janë në vështirësi në vendin pritës

1. Drejtuesi i postit konsullor i ofron ndihmën e nevojshme shtetasve shqiptarë, që gjenden në rrethin e juridiksionit, nëse vështirësitë nuk mund të mënjahen në një mënyrë tjetër. Kjo nuk vlen për shtetasit shqiptarë, të cilët njëkohësisht janë në zotërim dhe të shtetësisë së shtetit pritës; drejtuesi i postit konsullor mund t'i ofrojë ndihmë rrethit të personave të fundit, nëse për rastin konkret rrethanat e mundësojnë dhënien e ndihmës.

2. Lloji, forma dhe masa e ndihmës gjykohet nga drejtuesi i postit konsullor, duke pasur parasysh raportet e veçanta në shtetin pritës dhe nevojën për ndihmë nga shtetasi shqiptar. Në kuadrin e ndihmës përfshihet edhe sigurimi i këshillimit dhe i mbrojtjes ligjore.

3. Në raste ekstreme, kur është e domosdoshme ndihma financiare, ajo u bëhet e mundur shtetasve shqiptarë për udhëtimin për në një vend tjetër ose për t'u riatdhesuar, duke marrë paraprakisht miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në këto raste rikthimi i shpenzimeve të kryera është i domosdoshëm. Ky detyrim shtrihet deri tek familjarët, të afërmit ose prek trashëgiminë e personit që ka kërkuar ndihmë.

Neni 5

Dhënia e ndihmës shtetasve shqiptarë në raste katastrofash apo zhvillimesh politike të dhunshme në vendin pritës

1. Në rastet kur në vendin pritës ndodhin katastrofa natyrore, zhvillime politike, luftarake e revolucionare ose ngjarje të tilla të tjera që rrezikojnë ose dëmtojnë popullsinë në vendin pritës apo pjesë të saj, drejtuesi i postit konsullor duhet të marrë masat e nevojshme për t'i ardhur në ndihmë e për të marrë në mbrojtje shtetasit shqiptarë të rrezikuar a të dëmtuar. Kjo vlen edhe për familjarët e shtetasve shqiptarë që nuk janë shtetas shqiptarë.

2. Drejtuesi i postit konsullor disponon një listë, ku përmbahen të dhënat e nevojshme për shtetasit shqiptarë me banim në rrethin e juridiksionit dhe të autoriteteve ose institucioneve vendase, që ofrojnë ndihmë në raste katastrofash.

Neni 6

Ndihma për të burgosurit, përfaqësimi i shtetasve shqiptarë në organet gjyqësore të shtetit pritës

1. Drejtuesi i postit konsullor jep ndihmë dhe kujdeset për shtetasit shqiptarë të burgosur, në hetime ose të dënuar me heqje lirie në vendin pritës, nëse kjo nuk është kundër dëshirës së tyre. Drejtuesi i postit konsullor ndërhyr pranë autoriteteve përkatëse të shtetit pritës, kur vihet re se këtij rrethi të shtetasve shqiptarë nuk i janë garantuar të drejtat që u takojnë në përputhje me normat e ligjet ndërkombëtare dhe të shtetit pritës. Në veçanti shtetasve shqiptarë të burgosur drejtuesi i postit konsullor u siguron ndihmë në aspektin e mbrojtjes ligjore. Këtu përfshihet edhe rekomandimi i avokatëve mbrojtës të licencuar në vendin pritës për përfaqësimin e interesave të shtetasve shqiptarë në organet gjyqësore të shtetit pritës.

2. Drejtuesi i postit konsullor, pa shkelur normat e ligjet ndërkombëtare dhe ato të vendit pritës, u drejtohet organeve gjyqësore dhe autoriteteve të tjera të shtetit pritës për të marrë informacion për arsyet e ndalimit ose të arrestimit të shtetasve shqiptarë në rrethin e juridiksionit, veçanërisht për akuzat që u janë ngritur atyre. Nëse është e nevojshme, drejtuesi i postit konsullor mund të vizitojë shtetasit shqiptarë të ndaluar ose të arrestuar në rrethin e juridiksionit.

3. Drejtuesi i postit konsullor përfaqëson ose merr masat e nevojshme për garantimin e përfaqësimit të shtetasve shqiptarë para organeve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të shtetit pritës në rrethin e juridiksionit, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e atyre shtetasve shqiptarë që e kanë të pamundur të jenë të pranishëm a të ngarkojnë persona të tjerë. Drejtuesi i postit konsullor e merr përsipër këtë përfaqësim me dëshirën e shtetasve shqiptarë të interesuar dhe u bën të ditur këtyre të fundit rezultatet e përfaqësimit.

Neni 7

Ndihma për transportin e shtetasve shqiptarë që kanë vdekur në vendin pritës

1. Nëse nuk ekzistojnë mundësi të tjera, drejtuesi i postit konsullor merr masat e nevojshme për kryerjen e identifikimit, kur është e nevojshme, dhe për të lajmëruar familjarët e shtetasve shqiptarë që kanë vdekur në vendin pritës. Në qoftë se, në përputhje me dëshirën e të ndjerit/ndjerës apo dhe të familjarëve, do të kryhet transporti i trupit të shtetasve shqiptarë për në atdhe, drejtuesi i postit konsullor ndihmon familjarët në problemet e mundshme me dokumentacionin dhe planifikimin e transportit.

2. Kur familjarët e shtetasve shqiptarë ende nuk janë paraqitur dhe nuk ka mundësi të tjera, drejtuesi i postit konsullor merr masat e nevojshme për sigurimin e pasurisë ose sendeve të tjera që kanë lënë shtetasit shqiptarë të vdekur.

3. Në qoftë se trashëgimtarët e të ndjerit nuk mund të gjenden dhe kur ka kaluar një periudhë kohore e gjatë pas sigurimit të pasurisë së lënë nga shtetasit shqiptarë, drejtuesi i postit konsullor merr masat e nevojshme për t'ua përcjellë këtë pasuri organeve përkatëse shqiptare.

Neni 8

Ndihma për mbrojtjen e interesave pasurore dhe trashëgimore të shtetasve shqiptarë

1. Drejtuesi i postit konsullor ndihmon dhe interesohet për mbrojtjen e interesave pasurore të shtetasve shqiptarë, që banojnë në rrethin e juridiksionit. Ai u siguron atyre përkrahje dhe ndihmë këshillimore, kur u shkelen interesat e kësaj natyre.

2. Drejtuesi i postit konsullor ndihmon dhe interesohet për kthimin e pasurive e trashëgimive, për marrjen e pensioneve, të sigurimeve etj. shtetasve shqiptarë që nuk banojnë në rrethin e juridiksionit. Ai përfaqëson shtetasit shqiptarë, kur ata nuk e kanë të mundur të jenë vetë të pranishëm ose të ngarkojnë persona të tjerë pranë të gjitha autoriteteve të vendit pritës për mbrojtjen e interesave pasurore të tyre, kur ata e kërkojnë këtë dhe ndihmon për sigurimin e ndihmës së nevojshme këshillimore ose juridike.

3. Drejtuesi i postit konsullor ndihmon dhe interesohet në çështjet e trashëgimive dhe pronësive të tjera që u përkasin pasardhësve të shtetasve shqiptarë. Në qoftë se nuk ka mundësi të tjera, drejtuesi i postit konsullor, në interes dhe në emër të pasardhësve të shtetasve shqiptarë, për sa i

kërkohej nga të interesuarit, ndërmerr veprimet vijuese:

a) Ua bën të njohura organeve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të vendit pritës kërkesat dhe pretendimet në lidhje me trashëgimitë e pasardhësve të shtetasve shqiptarë.

b) U kërkon organeve kompetente të shtetit pritës të informohet për testamentet, trashëgimitë e lëna dhe aspektet juridike në lidhje me trashëgimitë.

c) U kërkon organeve kompetente të shtetit pritës sigurimin e trashëgimive, kur lind dyshimi i shpërdorimit të tyre apo humbjes së të drejtave të trashëgimisë.

ç) U kërkon organeve gjyqësore, po të jetë e nevojshme, duke u paraqitur vetë në gjyq, që të pajiset me vendimin e gjyqimit.

d) Pranon në ruajtje dokumente të rëndësishme, mjete financiare e sende me vlerë për t'i përcjellë te trashëgimtarët e shtetasve shqiptarë.

III. DETYRA TË TJERA ADMINISTRATIVE, TË PËRPUNIMIT TË AKTEVE TË GJENDJES CIVILE E TË DOKUMENTACIONIT

Neni 9

Përpunimi i dokumentacionit në çështjet e shtetësisë

Drejtuesi i postit konsullor përpunon dokumentacionin në çështjet e marrjes e të lënies së nënshtetësisë shqiptarë.

Neni 10

Përpunimi i dokumentacionit për lëshimin e pasaportave e të vizave

1. Drejtuesi i postit konsullor përpunon dokumentacionin për lëshimin dhe veprimet me pasaportat dhe dokumentet e tjera, që garantojnë lëvizjen në kufi të shtetasve shqiptarë.

2. Drejtuesi i postit konsullor përpunon dokumentacionin për lëshimin dhe veprimet me vizat e llojeve të ndryshme për lëvizjen e qytetarëve të huaj në kufijtë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Kryerja e akteve të gjendjes civile. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve të shtetasve shqiptarë

1. Në postet konsullore të lejuara më parë me urdhrin përkatës të Ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuesi i postit konsullor merr përsipër funksione të nëpunësve të gjendjeve civile në mbajtjen dhe regjistrimin e akteve të gjendjes civile. Për të përmbushur këtë detyrë ai mban regjistrat përkatës të martesave, lindjeve dhe vdekjeve.

2. Drejtuesi i postit konsullor si në paragrafin 1:

a) Lidh martesa, për sa të paktën njëri nga bashkëshortët është shtetas shqiptar dhe lëshon certifikata martesash. Lidhja e martesave nga drejtuesi i postit konsullor regjistrohet në regjistrin përkatës për martesat dhe njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme për të kryer veprimet e mëtejshme.

b) Regjistron në regjistrin e martesave edhe martesat e shtetasve shqiptarë të lidhura nga autoritetet përkatëse të shtetit pritës, sipas ligjeve në fuqi, në bazë të certifikatave zyrtare.

c) Lëshon lejen e martesës për shtetasit shqiptarë, të parashikuar nga ligji përkatës i Republikës së Shqipërisë, për sa martesa do të lidhet në zyrat e gjendjes civile të shtetit pritës në rrethin e juridiksionit dhe njëri nga bashkëshortët është i huaj.

3. Drejtuesi i postit konsullor, si në paragrafin 1, bën regjistrimin e shtetasve shqiptarë të lindur në rrethin e juridiksionit në regjistrin e lindjeve, në bazë të certifikatave zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse vendase.

4. Në afate të caktuara aktet përkatëse të gjendjes civile të lindjeve, vdekjeve dhe martesave dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme për t'ua përcjellë autoriteteve kompetente shqiptare.

Neni 12

Dokumentimi në përgjithësi

1. Drejtuesi i postit konsullor dokumenton fakte dhe procese që ndesh gjatë kryerjes së veprimtarisë konsullore, si dhe përpilon protokolle ose procesverbale.

2. Në veçanti drejtuesi i postit konsullor, me kërkesën e shtetasve shqiptarë:

a) përpilon deklarata, autorizime, testamentë, kontrata, garanci dhe prokura të thjeshta;

b) vërteton zyrtarisht nënshkrime dhe shenja gishtërinjsh (duarsh);

c) vërteton zyrtarisht ekstrakte, fragmente, dublikata dhe kopje dokumentesh.

3. Dokumentet e përpiluara nga drejtuesi i postit konsullor janë të barasvlefshme me ato të një noteri të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

4. Dokumentet, sipas kërkesës së të interesuarve, drejtuesi i postit konsullor mund t'i lëshojë edhe në një gjuhë të huaj. Në këtë rast ato nuk kanë nevojë të noterizohen.

Neni 13

Përkthimi i dokumenteve

1. Drejtuesi i postit konsullor bën përkthimin e dokumenteve dhe të akteve të tjera zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën e vendit pritës, ose në një gjuhë tjetër, dhe nga gjuha e vendit pritës, ose nga një gjuhë tjetër, në gjuhën shqipe.

2. Përkthimet e dokumenteve nga drejtuesi i postit konsullor janë të barasvlefshme me ato të një përkthyesi të regjistruar te një noter në Republikën e Shqipërisë dhe për pasojë nuk kanë nevojë të noterizohen.

Neni 14

Lëshimi i vërtetimeve për vërtetësinë e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare

1. Drejtuesi i postit konsullor lëshon vërtetime për autenticitetin e dokumenteve, rregullsinë e tyre për sa i përket ekstremiteteve dhe lëshimin nga organi kompetent shqiptar për t'u përdorur me tej në rrethin e juridiksionit. Vërtetimet mund të lëshohen dhe në një gjuhë tjetër, veç gjuhës shqipe, duke përfshirë atë të vendit pritës.

2. Vërtetimet si në paragrafin më lart lëshohen nga drejtuesi i postit konsullor vetëm kur ai nuk ka asnjë lloj dyshimi për vërtetësinë e dokumentit të paraqitur. Në të kundërtën drejtuesi i postit konsullor e verifikon dokumentin e paraqitur pranë autoritetit që e ka lëshuar.

Neni 15

Legalizimi i dokumenteve zyrtare të lëshuara nga autoritetet shqiptare dhe autoritetet e vendit pritës në rrethin e juridiksionit

1. Legalizimi vërteton në një dokument zyrtar vërtetësinë, e nënshkrimit të nëpunësit nënshkrues, cilësinë në të cilën nëpunësi nënshkrues ka proceduar dhe vërtetësinë e vulës me të cilën është pajisur dokumenti.

2. Dokumenti i paraqitur për legalizim vulozet me vulën e legalizimit. Përveç emrit, mbiemrit dhe cilësisë së nëpunësit nënshkrues të dokumentit, shënohet data dhe vendi i legalizimit, emri dhe mbiemri i drejtuesit të postit konsullor, nënshkrimi i drejtuesit të postit konsullor dhe vulozet me vulën zyrtare të postit konsullor.

3. Dokumentet që janë çliruar nga legalizimi në bazë të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe të nënshkuara nga Republika e Shqipërisë dhe shteti pritës, nuk lejohet të legalizohen.

4. Drejtuesi i postit konsullor legalizon dokumente zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë për t'u përdorur me tej në rrethin e juridiksionit.

5. Drejtuesi i postit konsullor legalizon dokumente zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse të vendit pritës në rrethin e juridiksionit, për t'u përdorur më tej në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Dorëzimi i postës zyrtare

Drejtuesi i postit konsullor merr masat për dorëzimin e dokumenteve dhe të postës zyrtare shtetasve shqiptarë a të huaj që qëndrojnë në rrethin e juridiksionit, ose autoriteteve të shtetit pritës, po

në rrethin e juridiksionit, me kërkesën e gjykatave dhe autoriteteve zyrtare shqiptare. Dorëzimi i dokumentacionit u konfirmohet me shkrim gjykatës ose autoritetit që ka bërë kërkesën.

Neni 17

Çështjet e lundrimit

1. Drejtuesi i postit konsullor merr masat për zgjidhjen e problemeve të anijeve që lundrojnë në brigjet e vendit pritës me flamurin shqiptar.

2. Drejtuesi i postit konsullor merr masat për zgjidhjen e problemeve që kanë lindur në bordin e anijeve, të cilat lundrojnë në brigjet e vendit pritës me flamurin shqiptar.

3. Në rast se anëtarët e ekuipazheve të anijeve si më lart kanë mbetur në tokë, për shkak të sëmundjeve, ose arsye të tjera, drejtuesi i postit konsullor merr masat e duhura për kthimin e tyre në atdhe.

IV. EMËRIMI DHE MARRJA E DETYRËS

Neni 18

1. Drejtuesi i postit konsullor dhe nëpunësit e tjerë konsullorë emërohen në bazë të ligjit të shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

2. Transmetimi i funksioneve konsullore te drejtuesi i postit konsullor bëhet sipas nenit 3, paragrafi 2. Pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe autoriteteve përkatëse zyrtare të vendit pritës depozitohet nënshkrimi i drejtuesit të postit konsullor dhe nëpunësve konsullorë, për sa ata do të jenë të autorizuar të ushtrojnë funksionet konsullore.

V. KUFIZIMET E USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË DREJTUESIT TË POSTIT KONSULLOR

Neni 19

Në veprimtarinë e tyre drejtuesi i postit konsullor dhe nëpunësit konsullorë janë të detyruar të respektojnë normat ndërkombëtare, Konventën e Vjenës për marrëdhëniet konsullore, datë 24 prill 1963, traktatet dhe marrëveshjet e Republikës së Shqipërisë me vendin pritës, ligjet ekzistuese në rrethin e juridiksionit dhe normat ligjore të Republikës së Shqipërisë.

VI. RRETHI I NËPUNËSVE KONSULLORË

Neni 20

Nëpunësit konsullorë të karrierës

1. Në rrethin e nëpunësve konsullorë të karrierës hyjnë nëpunësit e Republikës së Shqipërisë të emëruar në postet konsullore jashtë shtetit, të ngarkuar me funksione konsullore sipas nenit 18 paragrafi 1.

2. Me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme, nëpunës konsullorë mund të emërohen edhe në konsullatat e nderit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 21

Konsujt e nderit

1. Për përfaqësimin sa më të mirë të interesave të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve të Jashtme emëron konsuj të përgjithshëm nderi dhe konsuj nderi. Më poshtë me termin "konsull nderi" do të kihet parasysh edhe konsulli i përgjithshëm i nderit.

2. Konsulli i nderit është pjesë përbërëse e strukturës së shërbimit konsullor të Republikës së Shqipërisë. Kompetencat e konsullit të nderit përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Punëve të Jashtme.

3. Emërimi ka të bëjë me dhënien e titullit konsull nderi qytetarit shqiptar a të huaj me qëndrim të përhershëm në vendin pritës, me anë të certifikatës përkatëse që lëshon Ministri i Punëve të Jashtme. Procedura e emërimit të konsullit të nderit përfshin:

a) argumentimin e hollësishëm të nevojës së përfaqësimit të interesave të Republikës së Shqipërisë me konsull nderi në rrethin e juridiksionit të propozuar, shqyrtimin e kujdesshëm të përshtatshmërisë së figurës të kandidatit për konsullin e nderit;

b) marrjen e pëlqimit paraprak prej SHIK-ut për emërimin e kandidatit, që shqyrtohet për konsull nderi;

c) pas dhënies së titullit konsull nderi, ndërhyrjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme ose përfaqësisë diplomatike apo konsullore që mbulon rrethin e juridiksionit ku do të ushtrojë veprimtarinë konsulli i nderit, pranë ministrisë së punëve të jashtme të shtetit pritës, për lëshimin e ekzekuturës.

4. Konsulli i nderit merr përsipër përfaqësimin e interesave të Republikës së Shqipërisë menjëherë pas dhënies së ekzekuturës nga shteti pritës dhe për aq kohë sa është e nevojshme. Në qoftë se gjykohet se për arsye të ndryshme përfaqësimi i interesave të Republikës së Shqipërisë nuk është më i nevojshëm, me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme mund të kërkohet mbarimi i mandatit të konsullit të nderit. Konsulli i nderit mund të kërkojë në çdo kohë të heqë dorë nga titulli i tij. Titulli konsull nderi nuk është i trashëgueshëm.

5. Konsulli i nderit nuk mund të largohet nga posti i tij për një kohë të gjatë, përndryshe konsulli i nderit duhet të marrë në kohën e duhur miratimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

6. Konsulli i nderit duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme nëse punësohet nga një shtet tjetër, përveç shtetit pritës, nga një organizatë ndërkombëtare ose kur ka bërë kërkesë për një nënshtetësi tjetër.

7. Republika e Shqipërisë pranon përfaqësimin në territorin e saj të interesave të një shteti të huaj, me të cilin ajo ka marrëdhënie diplomatike a konsullore me anë të konsujve të nderit. Paraprakisht shteti dërgues duhet të marrë miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për emërimin e konsujve të nderit të tij. Ministria e Punëve të Jashtme, pasi të jetë konsultuar më parë me autoritetet ose institucionet e tjera të interesuara dhe duke pasur parasysh, në radhë të parë, parimin e reciprocitetit, gjykon për dhënien e miratimit.

8. Për lejimin e fillimit të veprimtarisë së përfaqësimit të interesave të shtetit dërgues, konsulli i nderit pajiset nga Ministria e Punëve të Jashtme me ekzekuturën përkatëse, pasi të ketë paraqitur certifikatën e emërimit të tij.

VII. VJELJA TAKSAVE NGA VEPRIMTARIA KONSULLORE

Neni 22

Taksat konsullore

Në veprimtarinë e tyre konsullore drejtuesi i postit konsullor kryen vjeljen e taksave në përputhje me normat ligjore përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

VIII. HYRJË NË FUQI

Neni 23

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerre aktet nënligjore përkatëse në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2162, datë 21.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

